

Procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe ankesës pranë Këshillit Bashkiak

E drejta e kërkesës dhe ankesës

Sipas nenit 9 të ligjit 139/2015 për vetëqeverisjen vendore çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t'u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Marrëdhëniet me publikun realizohen dhe në përputhje Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative", Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit"

Kërkesat, ankesat e qytetarëve janë objekt shqyrtimi nga këshilli bashkiak në kuadër të kompetencës së tij në lidhje me mbikëqyrjen e kontrollin e brendshëm të bashkisë, duke bërë të mundur marrjen e masave brenda fushës së përgjegjësisë së tij në lidhje me gjetjet e bëra në bazë të tyre.

Administrimi i ankesave dhe kërkesave apo vërejtjeve

- Këshilli është i detyruar të marrë kërkesat dhe ankesat apo vërejtjet drejtuar këshillit të bashkisë dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara sipas dispozitave ligjore (ligji 139/2015, neni 19/2). Përgjigjet e kërkesave dhe ankesave/vërejtjeve firmosen nga kryetari i këshillit bashkiak.
- Nëse konstaton që këshilli i bashkisë ka cënuar të drejtën për njoftim dhe konsultim publik, sipas parashikimeve të pikës 1, nenit 6, të ligjit 146/2014, si dhe kur nuk janë respektuar afatet e parashikuara në nenet 15 dhe 17 të po këtij ligji, mund të ankoresh pranë kryetarit të këshillit.
- Në çdo rast, këshilli i bashkisë njofton palët e interesuara për masat e marra dhe e fton të japë komentet dhe rekomandimet për projektaktin.
- **Sekretari i këshillit** i përcjell kryetarit të Këshillit kërkesat, ankesat, vërejtjet dhe ky i fundit më pas vendos nëse ato i duhen përcjelle fillimisht kryetarit të bashkisë apo komisioneve të këshillit.
- **Sekretari i këshillit** rregjistron në rregjistrin elektronik kërkesat, ankesat dhe vërejtjet drejtuar këshillit dhe mirëmban të dhënat e rregjistrit, përfshirë përgjigjet e dhëna.

- **Ne rast se nuk merr pergjigje-** formularin e ankesës të plotësuar, mund ta dërgoni në Zyrën e Komisionerit në adresën: ***e-mail info@idp.al , dorazi ose me postë në adresën: rruga “Abdi Toptani”, Tiranë.***